



Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 22 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, si dhe nenit 11 paragrafi 4 të Rregullores nr. 03/2023 për procedurat për hetimet administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 22.09.2025, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti DPKI-EETZSD-0209/25, për zyrtarin publik z. Durim Abdullahu, asistent i rregullt në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës, për shkak se nuk ka prova që e argumentojnë dyshimin për ekzistimin e konfliktit të interesit sipas dispozitave të Ligjit nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.
- II. Ky vendim është përfundimtar në procedurën administrative dhe i njëjti publikohet në uebfaqen zyrtare të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin publik z. Durim Abdullahu, asistent i rregullt në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (në vijim: LPKI) dhe Rregulloren nr. 03/2023 për procedurat për hetimet administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit.

Ky rast (DPKI-2044/24) ka filluar të trajtohet pas informatës/kërkesës së pranuar nga jashtë (raportuesi i rastit), me të cilën është ngritur dyshimi për konflikt të interesit për z. Durim Abdullahu, pasi që siç pretendohet, i njëjti në cilësi të anëtarit të Këshillit të Fakultetit Filozofik, ka qenë pjesë e vendimmarrjes (diskutimit dhe votimit) lidhur me mos aprovimin e kandidatëve për asistent të angazhuar (bashkëpunëtor të jashtëm) sipas Thirrjes publike nr. prot.1/225, e datës 30.05.2025, pika III [Fakulteti Filozofik], pozita nr. 13 dhe anulimin e kësaj pozite. Ndërkohë që, siç pretendohet, me njërin nga kandidatët për këtë pozitë, z. Durim Abdullahu në të kaluarën ka pasur raport personal i cili ka përfunduar dhe ka rezultuar me një proces penal ndërmjet tyre.

Tutje raportuesi i rastit ka theksuar se, citojmë pjesë relevante nga raportimi: "[...] kam aplikuar për bashkëpunëtorë të jashtëm në kuadër të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës, ku më 23.06.2025, jam propozuar për pozitën Nr. 13 në kuadër të pikës III të

Thirrjes publike Prot. Nr. 1/225, të dt. 30.05.2025. Këtë e konfirmon Raporti i Komisionit Vlerësues për Bashkëpunëtor të Jashtëm në Filozofi, Nr. 03/1909/1, i publikuar më 23.06.2025. Megjithatë, Këshilli i Fakultetit Filozofik, në mbledhjen e mbajtur më 09.07.2025, mori Vendimin Nr. Ref. 2208/01, të dt. 14.07.2025, me të cilin vendim nuk e miratoi Raportin e Komisionit Vlerësues për Bashkëpunëtor të Jashtëm në Filozofi, në lidhje me dy kandidatë, përfshirë edhe mua, dhe anuloi atë pjesë të raportit [...] ky vendim i Këshillit u mor në shkelje të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe të drejtës materiale. Vendimi në fjalë shkelë edhe Parimin e Ligjshmërisë dhe Nenin 29, paragraf 1.10 të LPPA, në lidhje me Nenin 6 të Ligjit Nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtimin e Funksionit Publik, sepse një nga anëtarët e Këshillit të Fakultetit Filozofik të UP-së, Durim Abdullahu, në cilësinë e asistentit në këtë fakultet, mori pjesë në diskutim dhe votim [...], pavarësisht se ai kishte konflikt interesi në raport me [njërin nga kandidatët] për Bashkëpunëtor të Jashtëm në këtë Fakultet [...]". Andaj, ka kërkuar nga Agjencia që: "[...] të konstatoj se Vendimi i Këshillit të Fakultetit Filozofik të UP-së, Ref. Nr. 2208/01, i datës 14.07.2025, është nxjerrë në sajë të konfliktit të interesit vetëm sa i përket dispozitivit III, dhe të rekomandoj UP-në që vendimmarrjen ta kthejë në pikën zero."

Rrjedhimisht në raportimin e rastit si më lart, përveç pretendimeve për konflikt të interesit sipas dispozitave të LPKI-së, janë ngritur edhe dyshime lidhur me (pa)rregullsinë dhe (kundër)ligjshmërinë e anulimit të thirrjes publike për pozitën sipas pikës nr 13 për bashkëpunëtor të jashtëm, si dhe lidhur me (jo)objektivitetin e pjesmarrjes së z. Durim Abdullahu në vendimmarrjen e këshillit të Fakultetit Filozofik, për këtë pikë.

Por, Agjencia konform mandatit dhe kompetencave ligjore që ka sipas Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, ka zhvilluar procedurën e hetimit administrativ duke trajtuar dhe shqyrtuar vetëm pretendimet për konflikt të interesit sipas dispozitave të LPKI-së, përkatësisht faktin nëse z. Durim Abdullahu ka qenë i përfshirë në vendimmarrje të këshillit të fakultetit për pozitën nr. 13 dhe nëse ka pasur lidhje të "personit të afërm" me ndonjërin nga kandidatët e refuzuar për bashkëpunëtor të jashtëm.

Agjencia, me shkresën zyrtare DPKI-1693/25, e ka njoftuar zyrtarin z. Durim Abdullahu lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së konfliktit të interesit. Pas kësaj, është organizuar dhe mbajtur një takim me të në Agjenci, me ç'rast i njëjti është njoftuar me pretendimet për konflikt të interesit dhe faktet që posedon Agjencia lidhur me këtë rast.

Zyrtari z. Durim Abdullahu, në takimin e mbajtur dhe përmes deklaramit të tij me shkrim të dërguar në Agjenci, ka dhënë sqarimet e tij lidhur me pretendimet e ngritura për konflikt të interesit, si dhe ka dorëzuar në Agjenci një aktgjykim të Gjykatës Themelore në Prishtinë në lidhje me raportet e tij me njërin nga kandidatët për pozitën nr. 13.

Zyrtari në fjalë, në lidhje me pjesmarrjen e tij në vendimmarrje në cilësi të anëtarit të këshillit të Fakultetit Filozofik për pikën nr. 13 të thirrjes publike për bashkëpunëtor të jashtëm, ka pranuar se ka qenë pjesë e diskutimit dhe votimit për këtë pikë, por ka theksuar se, citojmë nga deklarimi i tij: "[...] për shkak të paqartësive juridike që askush nuk ishte në gjendje t'i sqaronte, e madje as edhe një interpretim i lëshuar nga zyra juridike e UP-së, Dekani i Fakultetit Filozofik, e nxorri në votim këtë pozitë për anulim dhe ky propozim i tij i mori: 12 vota pro, 7 vota kundër dhe një abstenim. Rrjedhimisht Këshilli i Fakultetit Filozofik mori

vendim për anulimin e kësaj pike të konkursit, duke mos dashur të marrë përgjegjësitë e komisionit të kësaj pike, që në vend të një kandidati i kishte referuar dy kandidatë [...] në mbledhjen e Këshillit të Fakultetit Filozofik të datës 9 korrik 2025, nuk është votuar për ndonjërin nga dy kandidatët e referuar nga komisioni i pikës 13, [...] në mbledhje është nxjerrë për votim pika 13 e konkursit e artikuluar nga Dekani si propozim kështu: "Kush është për anulimin e kësaj pike të konkursit?". Rezultati i votimit ka qenë 12 vota pro, 7 vota kundër dhe një abstenim. Pra ne nuk kemi votuar për asnjërin kandidat, por për anulimin apo jo të pikës 13 të konkursit [...]".

Ndërsa, sa i përket dyshimeve për lidhje të afërsisë (person i afërm) me njërin nga kandidatët për pozitën nr. 13, z. Durim Abdullahu, ndër të tjera ka sqaruar se, citojmë pjesë relevante nga deklarimi i tij: *"[...] para 8 viteve, mes viteve 2014 deri më 2017, unë kam qenë në lidhje dashurie me njërin nga dy kandidatët e referuar në referat [...] kemi qenë në lidhje për rreth dy vite e gjysmë, afërsisht nga shkurti i vitit 2014 deri në nëntor 2017. [...] Që nga viti 2017, unë nuk kam patur asnjë lloj kontakti me zonjën në fjalë [...]".* Tutje, zyrtari në fjalë ka sqaruar se: *"[...] nuk kam qenë në dijeni që pjesëmarrja ime në mbledhje mund të paraqes eventualisht ndonjë konflikt interesi. Aq më tepër që kanë kaluar plot 8 vite prej kur unë dhe [njëri nga kandidatët e propozuar] jemi ndarë dhe unë jam krejtësisht i desenzituar dhe i depersonalizuar nga [njëri nga kandidatët e propozuar] si person. I tërë diskutimi i kolegëve dhe i imi atë ditë në mbledhje ka qenë në mbrojtje të nivelit të stafit akademik në Universitetin e Prishtinës, në mbrojtje të interesit publik dhe të të drejtave të anëtarëve të stafit akademik të UP-së."*

Tutje, me qëllim të sqarimit të rastit, Agjencia me shkresa të ndara ka kërkuar informata dhe dokumentacion nga Fakulteti Filozofik i Universitetit të Prishtinës (DPKI-1697/25) dhe nga Gjykata e Apelit të Kosovës (DPKI-1744/25). Institucionet në fjalë duke u përgjigjur në kërkesat e Agjencisë, kanë dërguar informatat dhe dokumentacionin e kërkuar.

Pas grumbullimit të informatave si më lartë, Agjencia pasi ka administruar si prova (ato që lidhen me vërtetimin e fakteve - pretendimeve për konflikt të interesit), raportimin e raportuesit të rastit përfshirë dokumentacionin plotësues dhe materialet e bashkangjitura, deklaratimet dhe sqarimet me shkrim përfshirë dokumentacionin e dorëzuar nga z. Durim Abdullahu, pastaj përgjigjet e Fakultetit Filozofik dhe të Gjykatës së Apelit të Kosovës në kërkesat e Agjencisë dhe dokumentacionin e bashkangjitur, si dhe dokumentet e siguruar nga Agjencia sipas detyrës zyrtare, ka konstatuar gjendjen faktike si në vijim:

Më datë 30.05.2025, Universiteti i Prishtinës ka shpallë Thirrjen publike për angazhim të profesorëve dhe asistentëve të angazhuar për ligjerata dhe ushtrime në bazë të nevojave të njësive akademike të Universitetit të Prishtinës për vitin akademik 2025/26, nr. prot.1/225, me të cilën përveç pozitave tjera është shpallë edhe pozita një asistent i angazhuar për ushtrime në një grup të lëndëve, pika III [Fakulteti Filozofik], pozita nr. 13¹. Thirrja publike ka qenë e hapur për aplikim nga data 30.05.2025, deri më datë 09.06.2025.

¹ Një asistent i angazhuar për ushtrime për lëndet: Histori e Filozofisë II - Empiricizmi dhe Racionalizmi (C)); Histori e Filozofisë III - Idealizmi klasik german (O); Hyrje në ideologjitë bashkëkohore (O); Hegeli dhe filozofia e shek. XIX; Hyrje në metafizikë dhe ontologji (O); Filozofi e shkencës (O); Filozofi e logjikës (C)); Logjikë deduktive (O) 8+8 ore.

Me Vendimin e Këshillit të Fakultetit Filozofik Ref. nr. 1839/01, i datës 18.06.2025, është formuar komisioni vlerësues prej tre (3) anëtarëve për pozitën nr. 13.

Referuar Raportit të komisionit vlerësues nr. 03-1909, i datës 23.06.2025, rezulton se për pozitën si më lartë (nr. 13), janë paraqitur tre (3) kandidatë. Ndërsa komisioni i ka propozuar, përkatësisht ka vlerësuar se dy (2) kandidatë (L. N. dhe L. M.) plotësojnë kriteret e parapara me konkurs.

Me Vendimin Ref. nr. 2208/01, i datës 14.07.2025, konkretisht pika III. e vendimit, Këshilli i Fakultetit Filozofik nuk ka aprovuar Raportin vlerësues për pozitën nr. 13, sipas thirrjes publike për angazhim të profesorëve dhe asistentëve të angazhuar për ligjerata dhe ushtrime për vitin akademik 2025/26, nr. prot.1/225, pasi që, siç precizohet në vendim, *për dy kandidatët ka vërejtje, vendime dhe interpretime andaj si e tillë pozita anulohet.*

Vendimi si më lartë i këshillit të fakultetit është marrë me dymbëdhjetë (12) vota pro, shtatë (7) kundër dhe një (1) abstenim.

Referuar Ekstraktit Ref. nr. 2493/01, i datës 03.09.2025, nga procesverbali i mbledhjes së XII-të të Këshillit të Fakultetit e mbajtur më datë 09.07.2025, si dhe incizimit të pikës 2 të rendit të ditës së kësaj mbledhje, rezulton se z. Durim Abdullahu ka qenë pjesë e mbledhjes, diskutimit dhe votimit lidhur me vendimmarrjen e Këshilli i Fakultetit Filozofik me të cilën nuk ka aprovuar Raportin vlerësues për pozitën nr. 13, dhe ka anuluar këtë pozitë.

Referuar, pretendimeve dhe informatave shtesë që ka dërguar raportuesi i rastit, deklaramentit me shkrim të z. Durim Abdullahu, ndërmjet tij dhe njërit nga kandidatët për pozitën nr. 13 të thirrjes publike (L. M.), ka pasur një proces gjyqësor penal, ku zyrtari në fjalë ka qenë palë e akuzuar ndërsa njëri nga kandidatët për pozitën nr. 13, ka qenë palë e dëmtuar.

Referuar Aktgjykimit P.nr.3286/18, i datës 08.12.2023, të Gjykatës Themelore në Prishtinë, zyrtari në fjalë është liruar nga akuza. Ky aktgjykim është vërtetuar me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.112/24, i datës 13.09.2024, me të cilin kjo gjykatë ka refuzuar si të pabazuar ankesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë dhe ka hudhë si të palejuar ankesën e palës së dëmtuar L. M.

Nga deklaratat e palëve dhe konstatimet e gjykatës në arsyetimin e Aktgjykimit P.nr.3286/18, i datës 08.12.2023, i Gjykatës Themelore në Prishtinë, i vërtetuar me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.112/24, i datës 13.09.2024, rezulton se z. Durim Abdullahu dhe njëri nga kandidatët për pozitën nr. 13 të thirrjes publike (L. M.), kanë bashkëjetuar nga muaji Tetor 2016 deri në muajin Qershor 2017.

Referuar dokumenteve si më lartë dhe deklarimeve të palëve, të njëjtit pas muajit Nëntor 2017 nuk kanë pasur raporte ndërmjet vete, përveç procedurave të mëpastajme gjyqësore që kanë rezultuar me vendimet gjyqësore si më lartë.

Andaj, në vështrim të pretendimeve dhe gjendjes faktike të konstatuar si më lartë, Agjencia vendosi si në pikën I. të dispozitivit të këtij vendimi, se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit, duke u bazuar në dispozitat e nenit 6 dhe nenit 17 lidhur me nenin 3, të LPKI-së.

Së këndejmi, konflikti i interesit është i lidhur ngusht me *vendimmarrjen* e zyrtarit në një çështje të caktuar, në të cilën zyrtari ka apo mund të ketë *interes* privat për vete apo për *personat e afërm* me të.

Kështu, me nenin 6 të LPKI-së është përkufizuar nocioni i konfliktit të interesit, ashtu që: *"Konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare"*, ndërsa me dispozitën e nenit 17 [Deklarimi rast për rast i interesave private të zyrtarit], paragrafi 1 të LPKI-së është përcaktuar se: *"Çdo zyrtar gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vetëdeklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij privat ose të personave të afërm me të lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhet shkak për lindjen e një konflikti të interesit dhe të tërhiqet nga kjo vendimmarrje."*

... lidhur me nenin 3 [Përkufizimet] paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të LPKI-së, me të cilin është përkufizuar se: *"interesi privat i personit zyrtar - nënkupton çfarëdo përparësie për personin zyrtar, familjen e tij, të afërmit, miqtë dhe personat apo organizatat me të cilat ai ka pasur apo ka marrëdhënie afariste"*, dhe nënparagrafi 1.6, me të cilin është përkufizuar se: *"Person i afërm me zyrtarin është – bashkëshorti ose personi që bashkëjeton, të afërmit në vijë të drejtë të gjakut pa kufizime, të afërmit në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt, adoptuesi, i adoptuari, i afërmi në gjini të krushqisë deri në shkallën e dytë si dhe çdo person fizik apo juridik i cili ka pasur ose ka një lidhje të përbashkët interesi privat pasuror ose jopasuror me zyrtarin. Për qëllime të këtij ligji, personi juridik konsiderohet si person i afërm, sipas dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Si dhe nënparagrafi 1.12, me të cilin është e definuar nocioni i vendimmarrje si: *"çasti i fundit i procesit vendimmarrës gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit apo kontratës si dhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes të cilat janë thelbësore dhe përcaktuese në të cilat pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i zyrtarit përcaktojnë përmbajtjen përfundimtare të aktit apo kontratës si dhe çdo veprim i zyrtarit në ushtrimin e funksionit publik."**

Në rastin konkret, në kuptim dhe zbatim të dispozitave si më lartë të LPKI-së, është fakt se z. Durim Abdullahu, në cilësi të asistentit të fakultetit përkatësisht anëtarit të Këshillit të Fakultetit Filozofik ka marrë pjesë në mbledhjen e datës 09.07.2025 të këshillit të këtij fakulteti, ka diskutuar dhe ka votuar, pra ka marrë pjesë në vendimmarrje, lidhur me Vendimin e Ref. nr. 2208/01, i datës 14.07.2025, me pikën III. të të cilit vendim, ky këshill nuk ka aprovuar Raportin vlerësues për pozitën nr. 13, sipas thirrjes publike nr. prot.1/225, ku njëri nga kandidatët e propozuar nga komisioni recensues ka qenë edhe L. M., me të cilën ka bashkëjetuar nga muaji Tetor 2016 deri në muajin Qershor 2017. Por, kjo situatë nuk paraqet situatë të konfliktit të interesit, përkatësisht nuk bie ndesh me dispozitat e LPKI.

Kjo për faktin se, njëri nga kandidatët e propozuar nga komisioni recensues për pozitën nr. 13 (L. M.), me të cilën, siç është konstatuar më lartë, z. Durim Abdullahu ka bashkëjetuar nga muaji Tetor 2016 deri në muajin Qershor 2017 (para më shumë se tetë viteve), nuk konsiderohet person i afërm i zyrtarit në fjalë, sipas përkufizimit të dispozitës së nenit 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6 të LPKI-së. Pra, raporti (bashkëjetesa nga muaji Tetor 2016 deri në muajin Qershor 2017) që z. Durim Abdullahu ka pasur me njërin nga kandidatët për pozitën nr. 13 (L.

M.), i cili raport ka përfunduar para më tepër se tetë (8) viteve, nuk konsiderohet si raport që personat në fjalë i bënë si persona të afërm me vete.²

Pjesëmarrja e zyrtarit në vendimmarrje dhe ekzistimi i interesit privat (çfarëdo përparësie për personin zyrtar, familjen e tij, të afërmit, miqtë dhe personat apo organizatat me të cilat ai ka pasur apo ka marrëdhënie afariste) të zyrtarit në atë vendimmarrje, janë kushte kumulative të cilat duhet të plotësohen në çdo rast për t'u konsideruar se ka konflikt të interesit në vendimmarrje, sipas dispozitave të nenit 6 dhe nenit 17, lidhur me nenin 3 të LPKI-së.

Në këtë rast, siç është konstatuar më lartë, z. Durim Abdullahu ka marrë pjesë në vendimmarrje të këshillit të fakultetit lidhur me Vendimin Ref. nr. 2208/01, i datës 14.07.2025, por këtu nuk është plotësuar kushti tjetër kumulativ, që është *interesi i privat*, përkatësisht përfitimi i çfarëdo përparësie për vete apo personat e afërm me të. Nga shkresat e lëndës dhe materialet e referuara, nuk rezulton që z. Durim Abdullahu të ketë pasur çfarëdo përparësie nga vendimmarrja në fjalë, dhe se personi që ka qenë kandidat për pozitën nr. 13, nuk konsiderohet person i afërm me të. Andaj, situata e parashtruar nuk bie ndesh me nenin 6, dhe 17, lidhur me nenin 3 të LPKI-së.

Me këtë rast, Agjencia ka pasur parasysh edhe pretendimet e raportuesit të rastit lidhur me dyshimet për jo objektivitet të z. Durim Abdullahu në vendimmarrjen si më lartë, si dhe referimin e shkeljes (së dyshuar) të dispozitave të Ligjit Nr. 05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative (në vijim: LPPA).

Por, fakti se zyrtari në fjalë me njërin nga kandidatët për pozitën nr. 13 (L. M.) ka pasur bashkëjetesë nga muaji Tetor 2016 deri në muajin Qershor 2017, si dhe fakti që të njëjtit kanë qenë palë kundërshtare në procesin gjyqësor penal sipas aktgjykimeve të lartpërmendura të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës së Apelit të Kosovës, *mund* të jenë rrethana për përjashtimin e zyrtarit nga një çështje administrative konform dispozitave të LPPA apo legjislacionit për zyrtarët publik, por kjo situatë nuk mund të cilësohet si rrethanë që *apriori* paraqet konflikt të interesit sipas dispozitave të LPKI-së.

Kësisoj, Agjencia vlerëson se rrethanat e tilla (bashkëjetesa dhe ekzistimi i procedurave / vendimeve gjyqësore penale) është dashur fillimisht të deklarohen dhe më pas të trajtohen në kuadër të Këshillit të Fakultetit Filozofik para vendimmarrjes së këtij këshilli për pozitën nr. 13, apo të njëjtat të trajtohen nga mekanizmat apo institucionet që kanë kompetencë për çështjen e referuar. Sepse siç u tha më lartë, Agjencia përkitazi me konfliktin e interesit ka kompetencë vetëm zbatimin e dispozitave të LPKI-së.

Me këtë rast duhet pasur në konsideratë zbatimin e dispozitave të LPPA-së për përjashtimin e zyrtarëve nga procedura administrative. Konkretisht, neni 29, paragrafi 1, nënparagrafët 1.6 dhe 1.10 të këtij ligji, me të cilin është përcaktuar se: "*Një nëpunës nuk duhet të përfshihet në*

² "Shembuj të personave fizikë që kanë interes të përbashkët me zyrtarin: [...] Bashkëshort/e i/e divorcuar së paku për një periudhë kohore [...] Një zyrtar mund të pyes veten se për sa kohë që nga [...] divorci, [...] ish-partnerët cilësohen persona të afërm. Si pikë referimi mund të merret periudha kohore prej pesë vitesh. [...]". Shih: Valts Kalnins, Udhëzues për administrimin e konfliktit të interesit në shërbimin publik, Këshilli i Evropës, Qershor 2019, fq. 10, <https://rm.coe.int/toolkit-for-managing-conflict-of-interest-in-the-public-service-alb/168097ed10> [vizituar më: 19.09.2025].

një procedurë administrative, nëse ka një interes personal direkt apo indirekt në çështjen në fjalë, në mënyrë të veçantë kur ndodhet në njërin nga këto situata: [...] 1.6. ndërmjet nëpunësit apo personave të përmendur në nënparagrafin 1.2. të këtij neni, ka një proces gjyqësor me palët; [...] 1.10. në çdo situatë tjetër, parashikuar shprehimisht me ligj apo që mund të vë në dyshim paanshmërinë e tij”, dhe të veprohet sipas nenit 30 dhe 31 të LPPA-së.

Dispozitat e LPKI-së nuk mëtojnë që të kufizojnë apo pengojnë ushtrimin e funksioneve publike, përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësiave ligjore dhe kushtetuese në institucione publike, por përkundrazi, njëri ndër qëllimet e rëndësishme të këtij ligji është funksionimi i institucioneve publike përmes parandalimit të shfrytëzimit të funksionit publik për interesa private, përkatësisht parandalimit të situatave të konfliktit të interesit, duke mbrojtur kështu interesin publik, ruajtur kredibilitetin dhe imazhin e institucioneve publike.

Agjencia vendosi si në pikën II. të dispozitivit të këtij vendimi, duke u bazuar në nenin 22 [Procedura administrative e Agjencisë për rastet e konfliktit të interesit], paragrafi 12 të LPKI-së, me të cilin është përcaktuar se: *“Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe shkeljen e dispozitave të këtij ligji, përfshirë veprimet e ndaluara ose të kufizuara në ushtrimin e funksionit publik, ushtrimin e veprimtarive të tjera, papajtueshmëritë në ushtrimin e funksionit publik, duhet të respektohen nga zyrtarët dhe institucionet përgjegjëse. Ato bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.”*, si dhe paragrafin 15 të këtij neni, me të cilin është përcaktuar se: *“Vendimet e Agjencisë në lidhje me konfliktin e interesit janë përfundimtare në procedurë administrative.”*

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Pala e pakënaqur ka të drejtë të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Themelore të Prishtinës, Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit ligjor prej tridhjetë (30) ditësh, nga data e pranimit të këtij vendimi.



Drejtor i Agjencisë për
Parandalimin e Korrupsionit

Vendimi iu dërgohet:

- z. Durim Abdullahu;
- Drejtorit të DPKI-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)